



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 29 korrik 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1554_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit, ngastra kadastrale nr. 01876-0 ZK Obiliq me kapacitet të instaluar prej 100 kW në Komunën e Obiliqit, e pranuar me datë 01.07.2022 nga aplikuesi personi juridik N.T.SH."BAST TRADE", me adresë: fsh. "Shkabaj" Komuna e Obiliq, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 29 korrik 2022 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit N.T.SH."BAST TRADE", për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit, ngastra kadastrale nr. 01876-0 ZK Obiliq me kapacitet të instaluar prej 100 kW në Komunën e Obiliqit.



- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi N.T.SH.“BAST TRADE”, me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR-90027827 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi N.T.SH.“BAST TRADE”, do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

A r s y e t i m

- ZRRE, me datë 01.07.2022 nga aplikuesi N.T.SH.“BAST TRADE”, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit, ngastra kadastrale nr. 01876-0 ZK Obiliq me kapacitet të instaluar prej **100 kW** në Komunën e Obiliqit.
 - Aplikuesi, s’bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 6314 të datës 24.06.2022 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin Nr. V 662 të datës 23.05.2022 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër e Komunës së Obiliqit.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit N.T.SH.“BAST TRADE”, dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike që do të vendosen në kulmin e objektit, ngastra kadastrale nr. 01876-0 ZK Obiliq me kapacitet të instaluar prej **100 kW** në Komunën e Obiliqit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
 - VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Izet Rushiti, Anëtar


Selman Hoti, Anëtar


Lutfie Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Obiliq,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së.